



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ**

Tiranë, Dhjetor 2016

RAPORT

“Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë, në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Fushë-Arrëz”

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pikat 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*, me Vendimin nr. 42, datë 19.04.2016, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Fushë-Arrëz”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Mbikëqyrja u realizua sipas programit të mbikëqyrjes nr. 338/1 prot., datë 19.04.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 338/2 prot., datë 19.04.2016, *“Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”*.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm duke u përcaktuar një objekt i gjerë kontrolli, që përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil; plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga Saimir Muçmataj dhe juristi Joni Marko, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Ilia Kukumi, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Fushë-Arrëz dhe iu dërgua institucionit të mbikëqyrur me shkresën nr. 338/3 prot., datë 27.10.2016, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes”*.

Pasi u njoh me problematikat e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes, projektraporti u nënshkrua nga Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe është dërguar me shkresën nr. 338/4 prot., datë 16.11.2016, protokolluar pranë Komisionerit, bashkë me vërejtjet dhe dokumentet përkatëse.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua dhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes, si më poshtë:

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

- Paraqitja para përgjegjësve për menaxhimin e burimeve njerëzore, njësisë së burimeve njerëzore, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes:

1. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me strukturimin, konstituimin dhe organizimin e brendshëm të institucionit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore për njohjen dhe përfitimin e statusit të nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Procesi i ristrukturimit, zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
4. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
5. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur nëpunësve kompetentë të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues*).
6. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i inspektimit, verifikoi dosjen individuale për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil si dhe çdo dokument tjetër lidhur me çështje të personelit që rregullohen shprehimisht nga ligji “Për nëpunësin civil”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me titullarin e institucionit ku u bisedua dhe u ra dakord, për objektin dhe drejtimit e inspektimit, si dhe dokumentacionin shkresor që do të vihej në dispozicion të grupit të inspektimit. Drejtori i Drejtorisë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore u caktua si person kontakti me grupin e punës;
- Grupi i punës shqyrtoi pozicionet e shërbimit civil, sipas organigramës dhe organikës së hollësishme të institucionit;
- Verifikoi dosjet individuale të çdo nëpunësi të punësuar në vendet e shërbimit civil, librezat e punës, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;

- Kontrollloi të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës (*nivelin e edukimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë etj.*), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- U verifikuan materialet që pasqyrojnë planin vjetor të pranimin në shërbimin civil, rastet e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, vlerësimet e punës dhe shënimet që shoqërojnë ato, etj.
- Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore iu kërkua që të paraqiste problemet me të cilat ajo ndeshet në praktikën e punës së përditshme me qëllim që të asistohen teknikisht për zgjidhjen e drejtë të tyre.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij projektraporti.

Përmbajtja e Raportit:

1) Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me strukturimin, konstituimin dhe organizimin e brendshëm të institucionit.

Bashkia Fushë-Arrëz, është organ i qeverisjes vendore, statusi i të cilës përcaktohet në ligjin nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, ku në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, përcaktohet bashkia si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore. Të njëjtin përcaktim ka bërë edhe pika 1, e nenit 5, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, aktualisht i shfuqizuar por që ka qenë në fuqi në momentin kur ligji për shërbimin civil, filloi efektet, duke e konsideruar bashkinë, si njësi bazë të qeverisjes vendore.

Pra, fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e konfirmon përfshirjen e këtij institucioni dhe nëpunësve të tij në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil. Në nenin 2, të ligjit në fjalë, është përcaktuar në mënyrë të shprehur se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, (*në datën 26.02.2014*), ligji për ndarjen administrativo-territoriale nuk ishte miratuar ende, e si rrjedhojë institucioni i mbikëqyrur përbëhej vetëm nga Bashkia Fushë-Arrëz, (*pa përfshirë njësitë administrative (ish Komunat)*) e funksiononte sipas strukturës miratuar me vendimin nr. 5, datë 13.02.2013, të Këshillit të Bashkisë, “*Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të bashkisë dhe pagat e punonjësve për vitin 2013*”. Ndërkohë, Njësitë Administrative, të cilat aktualisht janë në varësi të saj, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë, duke qenë se në atë kohë ishin njësi të pavarura të qeverisjes vendore, funksiononin sipas strukturave të miratuara me vendimet e Këshillave Komunalë përkatës (*struktura të cilat nuk i dispononte institucioni*).

Më tej, Bashkia Fushë-Arrëz ka funksionuar me strukturën e miratuar me vendimin nr. 11, datë 12.03.2014, të Këshillit të Bashkisë, “*Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të bashkisë dhe pagat e punonjësve për vitin 2014*” dhe strukturën e miratuar me vendimin nr. 06, datë 10.03.2015, të Këshillit të Bashkisë, “*Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të bashkisë*”

dhe pagat e punonjësve për vitin 2015”, deri në momentin e konstituimit pas zgjedhjeve vendore të 2015.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar” kjo bashki kaloi në proces konstituimi pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon bazuar në ndarjen administrativo-territoriale, që gjendet në rubrikën “Qarku Shkodër” ku citohet Bashkia Fushë-Arrëz, numri X, i aneksit ku përcaktohen ndarjet administrativo-territoriale, mbi të cilat vepron pushteti vendor.

Sipas përcaktimeve të ligjit më sipër, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Fushë-Arrëz dhe 4 (katër) Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë (këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të).

Për të rregulluar procesin e konstituimit, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”. Në Kreun IV “Transferimi i personelit”, të këtij vendimi përcaktohet se, marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet Njësive Administrative dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj dhe deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitore, e cila miratohet nga kryetari i saj.

Në zbatim të përcaktimeve të dispozitave më sipër, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, me Vendimin nr. 10, datë 03.09.2015, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve, tabelën e pagave dhe strukturën e organigramën e Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Njësive Administrative nën varësinë e saj.

Më tej, me përfundimin e procesit të konstituimit, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz me vendimin nr. 7, datë 29.02.2016, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe strukturën e organikën e Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Njësive Administrative nën varësinë e saj.

Në përmbajtjen e vendimit të mësipërm, konstatohet se, Prefekti i Qarkut Shkodër, ka evidentuar disa problematika (të tilla si mos përcaktimi në strukturë i sektorit për emergjencat civile e krizat dhe i sektorit të auditit të brendshëm, si dhe disa referenca të gabuara ligjore), të cilat janë vënë në dijeni të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, me shkresën nr. 212/1 prot., datë 11.03.2016, të Prefektit.

Pas kësaj, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, pas rishqyrtimit të vendimit nr. 7, datë 29.02.2016, ka vendosur ta shfuqizojë atë, me vendimin nr. 13, datë 15.04.2016, “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara”, duke zbatuar rekomandimet e Prefektit.

Aktualisht, institucioni i mbikëqyrur funksionon sipas strukturës së miratuar me vendimin nr. 13, datë 15.04.2016, të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe **ka gjithsej 95 pozicione pune**, nga të cilët **89** pozicione janë pjesë e aparatit të bashkisë dhe të njësive administrative dhe **6** pozicione, janë funksione të deleguara të shërbimit pyjor (pa përfshirë personelin e: arsimit parashkollor, 9 vjeçar, e të mesëm, rrugëve rurale dhe funksionit të ujitjes e kullimit), të cilat paraqiten të ndara më poshtë, në këtë mënyrë:

- *Aparati i Bashkisë Fushë-Arrëz, ka gjithsej 57 vende pune:*
 - Numri i funksionarëve politikë është **5** (Kryetar + 1 Zv. Kryetar + 1 Sekretar i kryetarit + 1 Sekretar i këshillit + 1 Drejtor Kabineti për mbikëqyrjen e të gjithë nëpunësve civil dhe administrativ të bashkisë);
 - Numri i nëpunësve të ofrimit direkt të shërbimeve për publikun është **1** (Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile);
 - numri i punonjësve administrativë është **30** (1 shofer administrate + 1 magazinier + 1 sanitar + 3 roje + 9 punëtor shërbime publike pastrim gjelbërim + 1 shofer pastrim gjelbërimi + 2 punonjës shërbimesh mirëmbajtje objektsh + 3 punonjës shërbimesh mirëmbajtje varrezash + 4 punonjës shërbime mirëmbajtje + 1 elektrikist + 1 roje objekti tregu + 3 punonjës të policisë bashkiake);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 21.
- *Aparati i njësisë administrative Qafë Mali, ka gjithsej 7 vende pune:*
 - Numri i funksionarëve politikë është **1** (Administratori);
 - numri i punonjësve administrativë është **3** (1 roje + 2 punonjës mirëmbajtje ujësjellësi dhe objektsh);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 3.
- *Aparati i njësisë administrative Blerim ka gjithsej 7 vende pune:*
 - Numri i funksionarëve politikë është **1** (Administratori);
 - numri i punonjësve administrativë është **3** (1 roje + 2 punonjës mirëmbajtje ujësjellësi dhe objektsh);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 3.
- *Aparati i njësisë administrative Fierzë, ka gjithsej 8 vende pune:*
 - Numri i funksionarëve politikë është **1** (Administratori);
 - Numri i nëpunësve të ofrimit direkt të shërbimeve për publikun është **1** (Nëpunës i zyrës së gjendjes civile);
 - numri i punonjësve administrativë është **3** (1 roje + 2 punonjës mirëmbajtje ujësjellësi dhe objektsh);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 3.
- *Aparati i njësisë administrative Iballë, ka gjithsej 10 vende pune:*
 - Numri i funksionarëve politikë është **1** (Administratori);
 - Numri i nëpunësve të ofrimit direkt të shërbimeve për publikun është **1** (Nëpunës i zyrës së gjendjes civile);
 - numri i punonjësve administrativë është **3** (1 roje + 2 punonjës mirëmbajtje ujësjellësi dhe objektsh);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 5.
- *Shërbimi Pyjor (funksion i deleguar) ka gjithsej 6 vende pune:*
 - numri i punonjësve administrativë është **1** (1 sanitare);
 - numri i pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil është 5.

Në këto kushte, nga sa u parashtrua më sipër, në Bashkinë Fushë-Arrëz, **janë 40** pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Ky numër ka dalë si konkluzion logjik i grupit të mbikëqyrjes, duke u bazuar në emërtesën e pozicioneve të punës, në strukturën e bashkisë, kategorinë e pagës, si dhe detyrat që kryejnë realisht

punonjësit në këto pozicione, pasi: së pari, në strukturën e institucionit nuk janë specifikuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil; së dyti, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e institucionit nuk ka realizuar një analizë për të përcaktuar numrin e pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil; së treti, institucioni nuk kishte hartuar përshkrimet e punës.

Grupimi i **40 pozicioneve** të punës pjesë e shërbimit civil, nisur nga kategoria dhe klasa sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, paraqitet në këtë mënyrë:

Tabelë: Klasifikimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së miratuar	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë dhe klasës
1.	Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues	Përgjegjës Sektori	9 pozicione sipas strukturës
2.	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialistë	7 pozicione sipas strukturës
		Inspektor	23 pozicione sipas strukturës
		Arkivist	1 pozicion sipas strukturës
Pozicione të shërbimit civil gjithsej			40

Nga analiza dhe shqyrtimi i strukturës aktuale të institucionit të mbikëqyruar, u konstatuan disa problematika, të cilat qëndrojnë si më poshtë:

- Në këtë institucion, sektori është struktura administrative më e lartë e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil. Konkretisht, struktura e administratës së institucionit të mbikëqyruar, paraqitet e sheshtë (*horizontale*) dhe është e formuar vetëm me njësi organizative në nivel sektori (*gjithsej 10 sektorë*), me një pozicion drejtues (*Përgjegjës sektori*) dhe të gjitha pozicionet e tjera të sektorit i raportojnë atij. Në këto njësi organizative, konstatohen raste kur pozicioni përgjegjësi i sektorit ka vetëm një pozicion në varësi. Nga ana tjetër, në një rast, konstatohet se një sektor përbëhet vetëm nga pozicioni i përgjegjës pa vartës. Kjo strukturë nuk ka njësi organizative në nivel drejtorie, e për rrjedhojë, nuk ka të përcaktuar pozicione pune të kategorisë të nivelit të lartë e të mesëm drejtues.
- Në përmbajtjen e kësaj strukture nuk pasqyrohen të ndarë funksionarët politikë, nga pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, apo punonjësit administrativë. Për rrjedhojë, nuk evidentohet, personeli pjesë e shërbimit civil dhe personeli ndaj të cilit nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil.
- Konstatohet se nuk janë hartuar formularët e përshkrimit të punës, për pasojë njësia përgjegjëse nuk ka se ku të bazohet, për të realizuar klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbim civil dhe për të evidentuar me saktësi, nëse pozicionet e punës kryejnë funksione publike dhe mbi ta zbatohet ligji për nëpunësin civil, apo nëse janë punonjës administrativ.
- Rezulton se, pothuajse të gjithë pozicionet e punës të nivelit ekzekutiv, pjesë të shërbimit civil në këtë strukturë, evidentohen nën emërtimin “*Inspektorë*” dhe bëhet fjalë konkretisht, për **23** pozicione sipas strukturës. Vetëm në një rast, pozicioni i punës është emërtuar sipas detyrës konkrete që kryen ai funksion; bëhet fjalë për pozicionin e punës “*Arkivist*”, në Sektorin e Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Konkluzione:

Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të përmbushur detyrat si më poshtë:

- Të plotësojë menjëherë formularët e përshkrimit të punës për çdo pozicion pune pjesë të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
- Bazuar në këto përshkrime pune, njësia përgjegjëse, duhet të bëjë ndarjen e qartë të pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, nga pozicionet e tjera për të cilat nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, duke i përcaktuar në mënyrë të specifikuar edhe në strukturën e institucionit, në një tabelë të dedikuar për këtë qëllim.
- Të rishikohen emërtesat e pozicioneve të punës, sipas Lidhjes 3, “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Në këto rrethana, njësisë përgjegjëse i lind si detyrë që emërtesat e pozicioneve të punës “Inspektor” e “Arkivist”, t’i ekuivalentojë me emërtesat përkatëse të pozicioneve të punës të përcaktuara në nenin 19, pika 7, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, Kreu II i titulluar “Klasifikimi” dhe Kreu III i titulluar “Grupet e pozicioneve të punës” si dhe lidhja 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, në përputhje me detyrat që kryejnë efektivisht në institucion.
- Njësia përgjegjëse duhet të rishqyrtojë strukturën organizative të institucionit, sipas parimit të hierarkisë administrative në shërbim civil, duke krijuar të paktën një njësi organizative në nivel drejtorie, ose nëse është e mundur më shumë se një të tillë. Njësia përgjegjëse të kujdeset që njësitë organizative në nivel sektori, t’i riorganizojë në bazë të identifikimit të kompetencave kryesore, në kuptim që pozicionet që kryejnë funksione të ngjashme, të grupohen në të njëjtën njësi organizative.

Për realizimin e kësaj procedure njësia përgjegjëse duhet t’i referohet standardeve të hartimit të strukturave organizative të përcaktuara në Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

2) **Plotësimi i kushteve ligjore për njohjen e përfitimin e statusit të nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

Deklarimi i statusit të punësimit për çdo punonjës të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Njësi Administrative në varësi të saj, është një veprim administrativ i cili duhej të ishte kryer, për shkak të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku thuhet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i

- nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- pika 4, *“nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
 - pika 6, *“Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Dispozitat e mësipërme dhe kërkesat e parashikuara në to, janë zbërthyer me hollësi në vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.*

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, janë verifikuar dhe analizuar të gjitha materialet shpresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit e cila është aktualisht në fuqi; listëprezencën e muajit shkurt 2014; dokumentacionin që pasqyron punësimin në një pozicion të shërbimit civil; kohëzgjatjen e periudhës së punësimit; dokumentacionin që vërteton procedurën e marrjes në punë si dhe dokumentet personale të punonjësve.

Më poshtë, po paraqesim në mënyrë analitike, mënyrën se si janë plotësuar **40** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.

A. Plotësimi i pozicioneve të punës në shërbim civil në përputhje me kërkesat specifike të ligjit për shërbimin civil.

A.1 Aparati i Bashkisë Fushë-Arrëz

Bashkia Fushë-Arrëz, është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil dhe ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe në bazë të ligjit nr. 8549/1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, i shfuqizuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësve të punësuar në pozicione të shërbimit civil rezulton se, njësia përgjegjëse e kësaj bashkie nuk është shprehur në asnjë rast, në lidhje me statusin e punësimit në shërbim civil për gjithë ata punonjës, që kanë qenë në marrëdhënie pune në këtë institucion në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për shërbimin civil.

Nga verifikimi i procedurave të ndjekura nga institucioni, për emërimet e punonjësve të bashkisë rezultoi se, nga **21** punonjës gjithsej, vetëm **8** prej tyre janë nëpunës civilë (*2 janë nëpunës civil ekzistues, 5 janë punonjës ekzistues me më shumë se një vit dhe 1 nëpunës është rekrutuar me procedurë konkurrimi*), ndërsa **13** punonjësit e tjerë janë emëruar me akte të thjeshta emërimi, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil.

Megjithëse ligji ka përcaktuar konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta të fundit, rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Situata e plotësimit të pozicioneve të punës në shërbim civil, në përputhje me ligjin, në aparatën e bashkisë, sipas mënyrës së përfitimit të statusit, pasqyrohet më poshtë:

- “Nëpunës civil ekzistues”, sipas përcaktimeve të nenit 67/3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë bashki janë evidentuar 2 raste, të cilët kanë përfituar statusin e nëpunësit civil sipas dispozitave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, i shfuqizuar. Në kuptim të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, këta punonjës kategorizohen si “nëpunës civil ekzistues”. Në mënyrë nominale, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. ******, aktualisht në pozicionin e punës “Jurist dhe Specialist për Prokurimet Publike”;

Sipas librezës së punës, kjo punonjëse ka filluar marrëdhënien e punës sipas procedurave të konkurrimit pranë Bashkinë Fushë-Arrëz, në datën 07.04.2004, në pozicionin “Jurist, Inspektore e Marrëdhëniet me Publikun dhe Sekretare e Kryetarit”.

Me vendimin nr. 31, datë 04.05.2005, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është konfirmuar si “nëpunës civil” në pozicionin “Jurist, Inspektore e Marrëdhëniet me Publikun dhe Sekretare e Kryetarit”.

Me aktin e emërimit kolektiv nr. 60, datë 22.10.2015, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz, në pikën 3, të këtij akti, me miratimin e strukturës transitorë pas konstituimit të bashkisë dhe ristrukturimit të saj, emërohet në pozicionin “Jurist dhe Specialist për Prokurimet Publike”, në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Nga verifikimi i këtij rasti, rezulton se njësia përgjegjëse e bashkisë, nuk është shprehur në lidhje me statusin e saj të punësimit. Në kuptim të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kjo punonjëse është nëpunëse civile dhe duhet të trajtohet si e tillë.

Konkluzione:

Komisioneri, në këtë rast, mospërfundimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil, e vlerëson si parregullsi. Për të rregulluar ligjshmërinë, njësia e përgjegjëse e bashkisë, bazuar në pikën 6, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të nxjerrë menjëherë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil, për punonjësen ******, në pozicionin e punës “Jurist dhe Specialist për Prokurimet Publike”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz dhe ta vendosë atë në dosjen personale.

2. *****

Kjo nëpunëse është rikthyer në punë në pozicionin “Specialiste Auditit”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, pranë kësaj bashkie me aktin nr. 15 prot., datë 23.05.2016, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz, në zbatim të Vendimit nr. 161, datë 13.09.2011, të Komisionit të Shërbimit Civil. Në këtë rast, përfshirja e saj në kategorinë “nëpunës civil ekzistues”, buron nga konstatimi nëpunës civil nga Komisioni i Shërbimit Civil, në përmbajtjen e vendimit të tij.

- “Punonjës ekzistues”, të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013, u gjendën të punësuar në vende pune pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më të madhe se 1 vit.

Në këtë bashki janë evidentuar 5 raste, të cilët në kuptim pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kategorizohen si “punonjës ekzistues”, të cilët në mënyrë nominale, përmenden më poshtë:

1. *****, aktualisht në pozicionin e punës “*Inspektore Finance*”

Kjo nëpunëse ka filluar marrëdhënien e punës pranë Komunës Qafë Mali, me urdhrin nr. 49, datë 18.07.2011, të Kryetarit të kësaj Komune, në detyrën “*Inspektor Finance*”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, prandaj njësia përgjegjëse e ish Komunës Qafë Mali, me aktin administrativ nr. 131/1 prot., datë 16.04.2015, me të drejtë, ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin “*Inspektor Finance*”.

Me shkrirjen e Komunës Qafë Mali, kjo nëpunëse është transferuar pranë aparatit të bashkisë, pas konstituimit dhe ristrukturimit të institucionit, me aktin kolektiv nr. 60, datë 22.10.2015, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz (pika 6, e këtij akti), në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*” në Bashkinë Fushë-Arrëz.

2. *****, aktualisht në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit*”

Sipas librezës së punës, ky punonjës ka filluar marrëdhënien e punës pranë Komunës Gjegjan, në datën 01.05.2007, në detyrën “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe Shërbimeve*”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur të punësuar në këtë pozicion, prandaj njësia përgjegjëse e komunës, me aktin administrativ nr. 1108/3 prot., datë 26.09.2014, me të drejtë ka deklaruar statusin e tij të punësimit në shërbim civil, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe Shërbimeve*”.

Me shkrirjen e Komunës Gjegjan, ky nëpunës është transferuar pranë aparatit të bashkisë, si pasojë e ristrukturimit, me aktin kolektiv nr. 60, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 4, e këtij akti), në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*” në Sektorin e Planifikimit të Territorit.

3. *****, aktualisht “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhënien e punës pranë Komunës Qafë Mali, me urdhrin nr. 58, datë 01.08.2011, të Kryetarit të kësaj Komune, në detyrën “*Juriste*”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, prandaj njësia përgjegjëse e Komunës Qafë Mali, me aktin administrativ nr. 136/1 prot., datë 20.04.2015, me të drejtë i ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin “*Juriste*”.

Me shkrirjen e Komunës Qafë Mali, pas konstituimit të bashkisë dhe miratimit të strukturës provizore, me aktin kolektiv nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz, pika 3, e këtij akti, është emëruar në pozicionin “*Inspektor Arkiv e Protokolli*”, pranë Njesisë Administrative Qafë Mali.

Në vazhdim, me aktin nr. 05 prot., datë 26.01.2016, të njesisë përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz, pasi u shpall fituese në përfundim të procesit të konkurrimit “*Për ngritje në detyrë*”, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, emërohet në detyrën “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, ku vazhdon edhe aktualisht.

4. *****, ka filluar marrëdhënien e punës pranë Komunës Fierzë, me urdhrin nr. 291 prot., datë. 15.09.2011, të Kryetarit të kësaj Komune, në pozicionin e punës “*Përgjegjës Finance*”.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në punë në këtë pozicion, prandaj njësia përgjegjëse e Komunës Fierzë, me aktin nr. 93 prot., datë 29.04.2014, me të drejtë i ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin që mbante, si “Përgjegjës i Sektorit Ekonomik”(kështu u ndryshua emërtimi pas strukturës së re).

Me shkrirjen e Komunës Fierzë, pas konstituimit të bashkisë dhe miratimit të strukturës provizore, me aktin kolektiv nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, pika 2, e këtij akti, ai ka kaluar në pozicionin “Inspektor Finance”, pranë Njesisë Administrative Fierzë, detyrë të cilën e ka pranuar.

Më tej, si pasojë e ristrukturimit, me miratimin e strukturës përfundimtare të bashkisë, me urdhrin nr. 32/1 datë. 20.04.2016, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz, është transferuar nga pozicioni “Inspektor Finance”, në Njësine Administrative Fierzë, në pozicionin “Specialist Auditi”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë të cilën gjithashtu e ka pranuar.

5. ***** aktualisht në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Përballimit të Emergjencave Civile”, ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Komunës Qafë Mali, në vitin 2008, në pozicionin “Inxhinier Pyjesh”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion, prandaj njësia përgjegjëse e Komunës Qafë Mali, me aktin nr. 138/1, datë 23.04.2015, me të drejtë, i ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin “Inspektor Pyjesh” siç emërtohej pozicioni sipas strukturës së asaj kohe.

Me shkrirjen e Komunës Qafë Mali, e pas konstituimit dhe ristrukturimit të bashkisë, me aktin administrativ nr. 39/51, datë 29.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, ai është liruar nga detyra për shkak të risrukturimit. Duke e konsideruar të padrejtë vendimin për lirimin nga detyra, nëpunësi në fjalë ka kërkuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rishikimin dhe rivlerësimin e aktit në fjalë dhe ky i fundit, në përfundim të procesit të verifikimit, pasi ka konstatuar zbatim jo të drejtë të legjislacionit të shërbimit civil, ka ndërhyrë me mjetet e tij ligjore, duke urdhëruar revokimin e aktit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës dhe përsëritjen e procesit të ristrukturimit sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar..

Në të njëjtën kohë, ky nëpunës ka paraqitur një ankesë, me të njëjtin objekt, pranë gjykatës kompetente, e cila në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, ka arritur në të njëjtin konkluzion për zbatim të gabuar të ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës në shërbimin civil, duke vendosur rikthimin e tij në punë.

Mbi këtë bazë, njësia përgjegjëse e bashkisë, me aktin nr. 16 prot., datë 23.05.2016, ka zbatuar vendimin gjyqësor, duke rikthyer në punë nëpunësin në fjalë, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Përballimit të Emergjencave Civile”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

- Punonjës të pranuar në shërbimin civil, rishtas, sipas procedurave konkurruese sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë institucion evidentohet **1** rast, ku pozicioni i punës pjesë e shërbimit civil është plotësuar sipas procedurave konkurruese, të parashikuara prej ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësin *****.

Ky nëpunës, është punësuar në pozicionin “Përgjegjës Finance” pasi ka konkurruar nëpërmjet procedurës për ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë. Me shpalljen e tij fitues nga Komisioni i

Ngritjes në Detyrë, njësia përgjegjëse e bashkisë, me aktin nr. 14 prot., datë 09.03.2016, e ka emëruar si nëpunës civil, në pozicionin “Përgjegjës Finance” në sektorin e Financës.

A.2 Aparati i Njësive Administrative, që është pjesë e shërbimit civil

Në Njësitë Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz është evidentuar vetëm **1 rast**, ku pozicioni i punës pjesë e shërbimit civil është plotësuar në mënyrë të rregullt, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësin *****.

Ky nëpunës fillimisht ka filluar marrëdhënien e punës pranë Komunës Blerim, me aktin kolektiv nr. 4, datë 06.04.2001, pika 3, e këtij akti, të Kryetarit të kësaj Komune, në pozicionin “Shef Finance”. Me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e Komunës Blerim, me aktin nr. 01, datë. 14.01.2015, me të drejtë, në bazë të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka deklaruar statusin e punësimit në shërbim civil, në pozicionin “Përgjegjës Finance”.

Me shkrirjen e Komunës Blerim, si pasojë e ristrukturimit të bashkisë, për shkak të procesit të konstituimit të saj, me aktin kolektiv nr. 60/2, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, pika 2, e këtij akti, ky punonjës është emëruar në pozicionin “Inspektor Finance”, në Njësinë Administrative Blerim, detyrë të cilën e ka pranuar.

Më tej, me urdhrin nr. 33/3 datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, i ndryshohet emërtimi i pozicionit të punës nga “Inspektor Finance” në Njësinë Administrative Blerim, në pozicionin “Inspektor Finance dhe Tatim Taksash”, në të njëjtën njësi administrative.

B. Plotësimi i pozicioneve të punës në shërbim civil në kundërshtim me ligjin

Në Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Njësitë Administrative të saj, janë konstatuar **31 raste**, (**13 raste në aparatit e bashkisë, 13 në aparatit e njësive administrative dhe 5 në shërbimin pyjor**) ku pozicionet e punës në shërbim civil janë plotësuar në kundërshtim me ligjin. Situata e konstatuar paraqitet si më poshtë.

B.1 Aparati i Bashkisë Fushë-Arrëz

Në Bashkinë Fushë-Arrëz janë evidentuar **13 raste**, ku pozicionet e punës në shërbim civil janë plotësuar me akte emërimi, pa kryer procedura rekrutimi, në kundërshtim me kërkesat e ligjit për shërbimin civil. Në mënyrë nominale, situata e konstatuar paraqitet e tillë, për punonjësit si më poshtë:

1. ***** ka filluar punë me urdhrin nr. 1/7, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “Shef i Sektorit të Pyjeve”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz. Më pas, me urdhrin nr. 38, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, ku punon edhe aktualisht.
2. ***** sipas librezës së punës, ka filluar marrëdhënien e punës në këtë bashki në datën 06.09.2013, në pozicionin “Inspektor Kontabël”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, e ka gjetur të punësuar në këtë pozicion, por për shkak të mungesës së nivelit të arsimit përkatës, që kërkon ky vend pune, njësia përgjegjëse nuk është shprehur në lidhje me statusin e saj të punësimit.

Më tej, me aktin nr. 33, datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është transferuar në pozicionin “*Inspektor Kontabël dhe Page*”. Sipas librezës së punës në datë 22.10.2015, ka kaluar përsëri në pozicionin “*Inspektor Kontabël*”, ku punon aktualisht.

3. *****, ka filluar punë në bashki, me aktin kolektiv të emërimit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 4, e këtij akti), në pozicionin “*Inspektor Pagash*”, në Sektorin e Financës, në Bashkinë Fushë-Arrëz.
4. *****, është emëruar në punë me urdhrin nr. 34, datë 11.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “*Arshivist*”, pranë kësaj bashkie. Më pas, me aktin kolektiv nr. 60, datë 22.10.2015, të Kryetarit Bashkisë Fushë-Arrëz, në pikën 7, të këtij akti, me strukturën transitore të miratuar pas konstituimit dhe riorganizimit të bashkisë, është emëruar në pozicionin “*Inspektor për arkivin dhe statistikën*”, në Sektorin e Financës në Bashkinë Fushë-Arrëz.
5. *****, ka filluar punë në bashki me urdhrin nr. 76, datë 01.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “*Inspektor i Planifikimit të Territorit*”, pranë kësaj bashkie, detyrë të cilën ende vijon ta kryejë.
6. *****, ka filluar punë në bashki me urdhrin nr. 67, datë 06.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “*Polic Bashkie*”, i cili është pozicion jashtë fushës së veprimit të shërbimit civil. Më tej, me urdhrin nr. 7, datë 25.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, kalon në një pozicion të shërbimit civil, e konkretisht në pozicionin “*Inspektor për Koordinim Zhvillim dhe Informacion*”, pranë kësaj bashkie. Më pas me urdhrin nr. 33/1, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet “*Inspektor për Koordinimin Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, ku dhe vijon aktualisht.
7. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/2, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 7, e këtij akti), në pozicionin “*Inspektor arkiv e protokollit*”, pranë Njësisë Administrative Blerim. Më tej, me urdhrin nr. 32/3, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, transferohet, duke u emëruar në pozicionin “*Inspektor për Emergjencat Civile*”, në Sektorin e Përballimit të Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, ku punon edhe aktualisht.
8. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/2, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (në pikën 19, të këtij akti), në pozicionin “*Përgjegjës Pastrim Gjelbërimi, Shërbimi Publik*”, në Sektorin e Shërbimeve, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë të cilën mban edhe aktualisht.
9. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 6, e këtij akti), në pozicionin “*Inspektore e Shërbimit Veterinar*”, në Sektorin e Shërbimeve, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë të cilën vijon ta mbajë edhe aktualisht.
10. *****, ka filluar punë në bashki, me aktin kolektiv të emërimit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 1, e këtij akti), në pozicionin “*Përgjegjëse e Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz. Më pas, me Urdhrin nr. 32/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, transferohet duke u

emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve Sociale”, pranë kësaj bashkie, detyrë të cilën mban dhe aktualisht.

11. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 6, e këtij akti), në pozicionin “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”, pranë Njesisë Administrative Qafë Mali. Më tej, me urdhrin nr. 32/5, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, transferohet në pozicionin “Inspektore e Çështjeve Sociale”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë në të cilën punon edhe aktualisht.
12. *****, ka filluar punë në bashki me aktin e emërimit kolektiv nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 2, e këtij akti), në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz. Me Urdhrin nr. 32/6, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, pas riorganizimit të strukturës ka mbetur në të njëjtin pozicion.
13. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 4, e këtij akti), në pozicionin “Inspektor i Zyrës së Tatim Taksave”, pranë Njesisë Administrative Qafë Mali. Më pas me urdhrin nr. 32/7, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, transferohet në pozicionin “Inspektor i Tatim Taksave”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, ku punon aktualisht.

B.2 Aparati i Njësive Administrative, pjesë e shërbimit civil.

Në Njësitë Administrative, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz janë evidentuar **13 raste**, (nga të cilat, **3 raste në njësinë Qafë Mali; 2 raste në njësinë Blerim; 3 raste në njësinë Fierzë, dhe 5 raste në njësinë Iballë**), ku pozicionet e punës në shërbim civil, janë plotësuar me akte emërimi, pa zhvilluar procedurat e rekrutimit, në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil. Situata e konstatuar paraqitet si më poshtë:

• Nga Njësia Administrative Qafë Mali:

1. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 2, e këtij akti), në pozicionin “Inspektor Finance”, pranë Njesisë Administrative Qafë Mali. Më pas me urdhrin nr. 33/2, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është transferuar në pozicionin “Inspektor Finance i Ndhmës Ekonomike dhe i Tatim-Taksave”, në Njesisë Administrative Qafë Mali, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë të cilën e kryen aktualisht.
2. *****, ka filluar punë në bashki me urdhrin nr. 11, datë 10.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “Inspektore Protokolli dhe Arshive”, në Njësinë Administrative Qafë-Mali, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, detyrë të cilën vijon ta kryejë.
3. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 5, e këtij akti), në pozicionin “Inspektor i Menaxhimit dhe Administrim Territorit”, pranë Njesisë Administrative Qafë Mali, ku punon edhe aktualisht.

• Nga Njësia Administrative Blerim:

1. *****, sipas librezës së punës ka filluar marrëdhënien e punës në Bashkinë Fushë-Arrëz, në datën 21.10.2015, në pozicionin “*Inspektor Pyjesh*”. Më tej, me strukturën përfundimtare të bashkisë, në datën 01.04.2016, ka kaluar në pozicionin “*Inspektor Protokolli*” dhe aktualisht me aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është emëruar në pozicionin “*Inspektor i ndihmës Ekonomike*”, pranë Njesisë Administrative Blerim.
2. *****, me aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “*Inspektor Arkiv e Protokoll*”, pranë Njesisë Administrative Blerim.

• Nga Njësia Administrative Fierzë:

1. *****, fillimisht ka filluar marrëdhënien e punës në Komunën Fierzë, me urdhrin nr. 6, datë 15.07.2011, të Kryetarit të kësaj Komune në pozicionin “*Arshivistë*”. Fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, e ka gjetur të punësuar në këtë pozicion, por për shkak të mungesës së nivelit të arsimit përkatës, që kërkon ky vend pune, njësia përgjegjëse nuk është shprehur në lidhje me statusin e saj të punësimit. Më tej, me aktin kolektiv nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pikën 3, të këtij akti, me strukturën transitore nga ristrukturimi si pasojë e konstituimit të bashkisë, emërohet në pozicionin “*Inspektor Arkiv e protokolli*”, pranë Njesisë Administrative Fierzë.
2. *****, ka filluar punë në bashki me urdhrin nr. 33/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, në pozicionin “*Inspektor i Ndihmës ekonomike dhe Financës*”, në Njësinë Administrative Fierzë, ku vazhdon edhe aktualisht.
3. *****, ka filluar marrëdhënien e punës në Komunën Fierzë, me urdhrin nr. 19, datë 01.08.2011, të Kryetarit të Komunës Fierzë, në pozicionin e punës “*Inspektor i Tatim-Taksave*”, të kësaj Komune. Fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, e ka gjetur të punësuar në këtë pozicion, por për shkak të mungesës së nivelit të arsimit përkatës, që kërkon ky vend pune, njësia përgjegjëse nuk është shprehur në lidhje me statusin e tij të punësimit. Më tej, pas miratimit të strukturës provizore, me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (*pika 5 e këtij akti*) është riemëruar në pozicionin “*Inspektor i Tatim-Taksave*”, pranë Njesisë Administrative Fierzë.

• Nga Njësia Administrative Iballë:

1. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (*pika 1, e këtij akti*), në pozicionin “*Inspektore Finance*”, pranë Njesisë Administrative Iballë, ku ende vijon të punojë.
2. *****, ka filluar punë në bashki, me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/4, datë 22.10.2015, (*pika 2, e këtij akti*), të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, me të cilin është emëruar në pozicionin “*Inspektor Protokolli*”, pranë Njesisë Administrative Iballë.
3. *****, ka filluar punë në bashki me aktin e emërimit kolektiv nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (*pika 2, e këtij akti*), në pozicionin “*Inspektor i Ndihmës Ekonomike*”, pranë Njesisë Administrative Iballë, detyrë të cilën vazhdon ta kryejë edhe aktualisht.

4. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 3 e këtij akti), në pozicionin “Inspektor i Tatim-Taksa”, pranë Njesisë Administrative Iballë, detyrë të cilën vijon ta kryejë aktualisht.
5. *****, ka filluar punë në bashki me aktin kolektiv të emërimit nr. 60/4, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, (pika 3, e këtij akti), në pozicionin “Inspektor Veterinar”, pranë Njesisë Administrative Iballë, detyrë të cilën vijon ta kryejë aktualisht.

B.3 Punonjësit e Shërbimit Pyjor (funksion i deleguar)

Në sektorin e Shërbimit Pyjor, i cili është njësi me funksione të deleguara pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, janë evidentuar **5 raste**, ku pozicionet e punës në shërbim civil janë plotësuar me akte emërimi në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil. Në mënyrë nominale, po i paraqesim këto raste, sipas punonjësve që i plotësojnë këto pozicione:

1. *****, me aktin nr. 38/1, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Shërbimit Pyjor.
2. *****, me aktin nr. 118, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Shërbimit Pyjor.
3. *****, me aktin nr. 1/11, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Shërbimit Pyjor.
4. *****, me aktin nr. 1/10, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Sektorin e Shërbimit Pyjor.
5. *****, me aktin nr. 47/1, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, emërohet në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Sektorin e Shërbimit Pyjor.

Konkluzion:

Gjithë pozicionet e mësipërme të punës (**31 pozicionet**) janë pjesë e shërbimit civil dhe janë plotësuar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Këto emërimet nuk janë kryer sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, apo nëpërmjet procedurave që synojnë sistemin e karrierës në shërbim civil, të cilat janë lëvizja paralele apo ngritja në detyrë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe në nenet 115/a dhe 116/c, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i shfuqizuar, por që lejohet të veprojë, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, aktet administrative për emërimin e **31 punonjësve** në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të pasqyruara më sipër, të dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil, duhet të anulohen, si akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Për rregullimin e ligjshmërisë në rastet e mësipërme, njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin administrativ të anulimit të gjithë akteve të mësipërme të emërimit, nga ana e organit publik që i ka nxjerrë ato (*Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz*) dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të paligjshme të punësimit për personat në fjalë.

- Të anulohet aktin nr. 38, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Përgjegjës Sektori i Auditit të Brendshëm*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 33, datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor Kontabiliteti Sektori i Financës*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 4, të aktit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor Pagash Sektori i Financës*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 34, datë 11.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Arkivist*”, në Sektorin e Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, pranë Bashkisë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 76, datë 01.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor i Planifikimit të Territorit*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 33/1, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor për Koordinimin, Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë*”, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, pranë Bashkisë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 32/3 datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor i Përballimit të Emergjencave Civile*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 19, të aktit nr. 60/2, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Përgjegjës Sektori i Shërbimeve*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 6, të aktit nr. 63, datë 26.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor Veteriner*”, në Sektorin e Shërbimeve, pranë Bashkisë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 32/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Përgjegjës Sektori i Çështjeve Sociale*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 32/5, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Inspektor i Çështjeve Sociale*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 32/6, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës in ***** në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

- Të anulohet aktin nr. 32/7, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor i Tatim Taksave*”, në Bashki dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 33/2, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Finance dhe Ndhmës Ekonomik*”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 11, datë 10.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Protokollit*”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 5, të aktit nr. 60/1, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor i Menaxhimit dhe Administrimit Territorit*”, në Njësinë Administrative Qafë Mali dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Protokollit*”, në Njësinë Administrative Blerim.
- Të anulohet aktin nr. 103, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Blerim dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 3, të aktit nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Protokollit*”, në Njësia Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 33/4, datë 20.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Ndhmës Ekonomike dhe Financës*”, në Njësinë Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 5, të Aktit nr. 60/3, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Tatim Taksa*”, në Njësinë Administrative Fierzë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 1, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Finance*”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 2, të aktit nr. 60/4, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Protokollit*”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 2, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet pikën 3, të aktit nr. 66, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “*Inspektor Tatim Taksa*”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

- Të anulohet pikën 3, të aktit nr. 60/4, datë 22.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Inspektor Veterinar”, në Njësinë Administrative Iballë dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 38/1, datë 29.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 118, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 1/11, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Specialist”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 1/10, datë 06.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.
- Të anulohet aktin nr. 47/1, datë 23.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, që emëron punonjës të ***** në pozicionin “Specialist i Administrimit të Pyjeve”, në Shërbimin Pyjor dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit.

Pozicionet e mësipërme duhen të shpallen vakante dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, si dhe në përputhje me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

3) Procesi i ristrukturimit, zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Baza ligjore dhe kriteret mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (aktet e lirim të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja), në lidhje me veprimtarinë e njësisë përgjegjëse, janë:

- Kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Kërkesat e Kreut III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave;
- Përcaktimet e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave.

Ashtu si është sqaruar dhe në rubrikën e parë të këtij raporti, Bashkia Fushë-Arrëz, me hytjen në fuqi të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar”, ka kaluar në proces konstituimi pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave përcaktohet se, marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet Njësive Administrative dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitore.

Në zbatim të përcaktimeve të dispozitave më sipër, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz me Vendimin nr. 10, datë 03.09.2015, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve, tabelën e pagave dhe strukturën e organigramën transitore të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Njësive Administrative nën varësinë e saj.

Nga shqyrtimi i dokumenteve që materializojnë procesin e ristrukturimit, konstatohet se institucioni i mbikëqyrur, për implementimin e strukturës transitore të administratës, të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, nuk ka zbatuar asnjë nga kërkesat ligjore të ristrukturimit, sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktit nënligjor dalë në zbatim të tij.

Në përfundim për të realizuar këtë proces ristrukturimi, Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, me aktin administrativ nr. 39, datë 29.09.2015, “Për vënien në funksionim të organikës të miratuar me VKB nr. 10, datë 03.09.2015”, ka vendosur implementimin e strukturës tranzitore dhe me akte individuale, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës për të gjithë punonjësit e bashkisë.

Më tej, me anën e akteve administrative në grup, Kryetari i bashkisë ka riemëruar disa prej punonjësve të cilët punonin edhe më parë në bashki, sipas vlerësimit të tij subjektiv dhe ka emëruar punonjës të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, pa respektuar procedurat e konkurrimit.

Këto veprime arbitrare, janë konstatuar edhe në trajtimin e mëparshëm, të disa ankesave konkrete, të paraqitura prej nëpunësve, *****, punonjëse pranë Bashkisë dhe *****, *****, e *****, punonjës pranë Njesisë Administrative Qafë Mali.

Pas kryerjes së hetimit administrativ në lidhje me problemin që ngrihej në këto ankesa, u arrit në përfundimin se nga ana e drejtuesit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe strukturave të saj, nuk janë respektuar rregullat dhe procedurat ligjore, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si në drejtim të kryerjes së procesit të ristrukturimit, ashtu dhe të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve.

Po kështu, nga institucioni nuk janë zbatuar edhe masat që janë kërkuar të merren për përmirësimin e gjendjes së ligjshmërisë në vendimet nr. 2, datë 11.01.2016 dhe nr. 3, datë 11.01.2016, të Komisionerit, konkluzionet e të cilave janë arritur në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankesat e mësipërme.

Konkretisht, në gjithë rastet e marrëdhënieve të parregullta të punës, për shkak se janë lidhur në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga dispozitat që rregullojnë shërbimin civil, duhet të veprohet për ndërprerjen e menjëhershme të tyre dhe fillimin nga e para, të procesit të ristrukturimit, duke nisur me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe zbatimin prej këtij të fundit të gjithë kritereve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në vijim të analizës së procesit të ristrukturimit të institucionit, konstatohet se, me përfundimin e procesit të konstituimit, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz me vendimin nr. 13, datë 15.04.2016, “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative,

Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara”, ka miratuar strukturën përfundimtare të Bashkisë.

Nga shqyrtimi i dokumenteve që materializojnë procesin e ristrukturimit, gjatë implementimit të strukturës përfundimtare, konstatohet se, edhe në këtë rast institucioni nuk ka zbatuar asnjë nga kërkesat e përcaktuara në ligjin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë e për zbatim të tij.

Nga përmbajtja e observacioneve të dërguara nga Bashkia Fushë-Arrëz kërkohet të rivlerësohen konkluzionet e arritura në paragrafin e tretë të pjesa “Konkluzione”, (tek nënparagrafët që fillojnë me: së dyti...dhe së treti...), të projektraportit dërguar pranë institucionit me shkresën nr. 338/3, datë 27.10.2016, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes”, në të cilat është mbajtur qëndrimi si më poshtë:

Së dyti**, të krijohet mundësia për sistemimin në punë të nëpunësve ** e ***** sipas rekomandimeve të Komisionerit, në një pozicion pune të shërbimit civil, të së njëjtës kategori në përputhje me kërkesat e vendit të punës dhe cilësitë personale të nëpunësit, në ndonjë prej pozicioneve të cilat janë plotësuar në kundërshtim me ligjin.*

Së treti**, të sistemojë menjëherë punonjësit e rikthyer me vendim gjyqësor të formës së prerë, e konkretisht punonjësit ** (Vendimi nr. 36, datë 19.03.2012, të KSHC, të lënë në fuqi nga Gjykata) dhe ***** (Vendimi nr. 27, datë 09.03.2012, të KSHC, të lënë në fuqi nga Gjykata), në përputhje me kërkesat dhe radhën e përcaktuar nga neni 66/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (shtuar me ligjin nr. 178/2014)”.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve, njësia përgjegjëse dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, kanë ngritur argumentet si më poshtë:

Në lidhje me sistemimin në punë të nëpunësve ***** e ***** sipas rekomandimeve të Komisionerit, në një pozicion pune të shërbimit civil, të së njëjtës kategori në përputhje me kërkesat e vendit të punës dhe cilësitë personale të nëpunësit, në ndonjë prej pozicioneve të cilat janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, institucioni sqaron se rikthimi i tyre në punë është i pamundur për arsye se këta punonjës aktualisht janë në proces gjyqësor (fakt për të cilin, institucioni nuk ka dërguar asnjë dokument për të vërtetuar fillimin e ndonjë procesi gjyqësor) i cili nuk ka përfunduar akoma me një vendim të formës së prerë.

Ndërsa në lidhje me zbatimin e vendimeve të formës së prerë për rikthimin në detyrë të punonjësve ***** dhe ***** institucioni pretendon se këta punonjës nuk plotësojnë kërkesat e posaçme për asnjë nga pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil për arsye se këta punonjës nuk plotësojnë kriterin e diplomës së arsimit të lartë (edhe ky pretendim nuk është i shoqëruar me dokumente provuese), në këto kushte është i pamundur sistemimi i tyre.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rishqyrtoi pretendimet më sipër, në përfundim të të cilit rezultoi si më poshtë:

Si për punonjësit ***** e ***** të cilët janë liruar në mënyrë të padrejtë nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, pa respektuar procedurën e kërkuar nga ligji, ashtu dhe për gjithë punonjësit e tjerë ekzistues të bashkisë dhe njësive administrative të cilët preken nga procesi i ristrukturimit, duke përfshirë edhe punonjësit e kthyer me vendime gjyqësore të formës së prerë, procesi duhet të fillojë nga e para.

Për këtë duhet të ngrihet Komisioni i Ristrukturimit, i cili duke respektuar rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreun III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave (i cili ishte efektiv në kohën që u krye implementimi i strukturës së fundit), të bëjë vlerësimin e gjithë nëpunësve që janë në dispozicion, duke i krahasuar me kërkesat e përgjithshme e të veçanta të pozicioneve aktuale të punës.

Në rast se një nëpunës plotëson kushtet për të zënë një pozicion të caktuar, atëherë ai duhet të emërohet “pas ristrukturimit” në atë pozicion pune. Kështu duhet të veprohet për gjithë punonjësit duke pasur parasysh në radhë të parë nëpunësit civilë ekzistues.

Duhet pasur parasysh siç u tha dhe më sipër, që në këtë proces, të përfshihen dhe nëpunësit ***** e ***** të trajtuar me vendim të Komisionerit në kuadër të inspektimit, përfshirja e të cilëve është një detyrim ligjor që buron nga kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, procedurë e cila ka mbetur e pazbatuar nga institucioni dhe nuk ka lidhje me objektin e padisë paraqitur në gjykatë nga punonjësit.

Gjatë këtij procesi, në rastin që Komisioni i Ristrukturimit do të vendosë të propozojë për transferimin e këtyre punonjësve në një pozicion pune të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, ku ata plotësojnë kërkesat e posaçme të pozicionit të punës, njësia përgjegjëse duhet të miratojë këto propozime dhe këta nëpunës do të vazhdojnë marrëdhënien e punës me institucionin.

Vetëm në rastin e pamundësisë objektive të sistemimit të atyre punonjësve që nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme e të posaçme të një pozicioni të lirë pune, atëherë duhet të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke u njohur atyre, të drejtat e parashikuara prej pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe të drejtën që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.

Në lidhje me punonjësit ***** dhe ***** rrikthimi i të cilëve është vendosur me vendim gjyqësor të formës së prerë, Komisioneri kërkon përfshirjen e tyre në procesin e ristrukturimit, gjatë kryerjes të të cilit, Komisioni i Ristrukturimit, mbas përfundimit të procesit të verifikimit për sistemimin e tyre në ndonjë pozicion të lirë të shërbimit civil, të vendosë të propozojë sistemimin e tyre në rast se plotësojnë kriteret e vendit të punës si dhe nivelin arsimor që kërkon ky pozicion. Në rast se këta punonjës nuk mund të sistemohen për shkak të mosplotësimit të nivelit arsimor (ashtu si shprehet institucioni në *observacion*), të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit për këta punonjës duke u njohur atyre, të drejtat e përcaktuara prej vendimit gjyqësor dhe prej pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzione:

Përfundimisht, në mënyrë të përmbledhur veprimet e parregullta administrative të përshkruara më sipër, duhet të rregullohen duke respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, sipas udhëzimeve të mëposhtme:

- ✓ Procesi i ristrukturimit duhet të realizohet duke marrë parasysh strukturën përfundimtare të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, pas hartimit të përshkrimeve të punës, dhe përcaktimit të kërkesave të përgjithshme e të posaçme për secilin pozicion, që është pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që përbën një kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi, apo transferimi punonjësve, kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës.
 - ✓ Procesi i ristrukturimit të Bashkisë Fushë-Arrëz për implementimin e strukturës, duhet të kryhet duke respektuar të gjitha kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.
 - ✓ Procesi i ristrukturimit të fillojë me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili është organi kompetent për tu shprehur në lidhje me mundësinë ose pamundësinë e sistemit të secilit prej punonjësve ekzistues të institucionit (përfshirë dhe punonjësit *****, *****, *****, *****, ***** dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë) dhe për të paraqitur para njësisë përgjegjëse propozimet përkatëse për emërim apo transferim të nëpunësve, në përputhje me kërkesat e vendit të punës dhe cilësitë personale të nëpunësit, në ndonjë prej pozicioneve të cilat janë të lira, të ristrukturuara, apo janë të plotësuara në mënyrë të kundërligjshme.
 - ✓ Vetëm në rast të pamundësisë së sistemit të punonjësve të mësipërm të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbim civil për këta punonjës duke u njohur atyre, të drejtat e parashikuara prej pikave 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - ✓ Komisioni i Ristrukturimit, propozimet për transferimin e punonjësve nga ristrukturimi t’i shoqërojë me relacionin përkatës, duke argumentuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe arsyet për të cilat kërkohet sistemimi ose pamundësia e sistemit të punonjësve të institucionit, me komentet përkatëse individualisht për çdo punonjës, të cilat të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe t’i paraqitet njësisë përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
 - ✓ Në përfundim, njësia përgjegjëse e Bashkisë, në bazë të propozimit të komisionit, duhet të nxjerrë vendimin përfundimtar të transferimit, në mënyrë individuale për çdo nëpunës.
- 4) **Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar).**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikuan procedurat e konkurrimit në këtë institucion për të parë se si janë zbatuar kërkesat e kreut IV “Pranimi në shërbimin civil” dhe V “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe të Vendimit nr. 243, datë

18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Këto dispozita ligjore e nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedura të hollësishme të cilat duhet të ndiqen për plotësimin e pozicioneve të lira të punës, pjesë të shërbimit civil.

Nga procesi i verifikimit u konstatua se, në këtë institucion, prej momentit të konstituimit, janë realizuar 3 procedura konkurrimi, prej të cilave, dy konkurreme për të plotësuar pozicione pune të kategorisë drejtues e të nivelit të ulët, të cilat janë realizuar me anën e procedurave të ngritjes në detyrë dhe një konkurrim për të plotësuar një pozicion të nivelit ekzekutiv, i cili është realizuar me anën e procedurës së lëvizjes paralele. Konkretisht, bëhet fjalë për procedurat e paraqitura më poshtë.

Procedura e Ngritjes në Detyrë (2 raste)

Bashkia Fushë-Arrëz, për të plotësuar pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Financës”, ka organizuar procedurat e ngritjes në detyrë. Për këtë arsye, me urdhrin nr. 06, datë 12.02.2016, të Kryetarit të bashkisë është ngritur Komisioni i pranimin të kandidatëve (KPP) për këtë konkurrim. Në përfundim të vlerësimit të testimin me shkrim, dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës me gojë, Komisioni ka vlerësuar të rendisë fitues të këtij konkurrimi, me më shumë se 70 pikë, kandidatin ***** (materializuar me procesverbalin nr. 07 prot., datë 24.02.2016).

Për të plotësuar pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, ka organizuar procedurat e ngritjes në detyrë. Për këtë arsye, me urdhrin nr. 01, datë 11.01.2016, të Kryetarit të bashkisë është ngritur Komisioni i pranimin të kandidatëve (KPP) për këtë konkurrim. Në përfundim të vlerësimit të testimin me shkrim, dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës me gojë, Komisioni ka vlerësuar të rendisë fitues të këtij konkurrimi, me më shumë se 70 pikë, kandidaten ***** (materializuar me procesverbalin nr. 02 prot., datë 19.01.2016).

Procedura e Lëvizjes Paralele (1 rast)

Për të plotësuar një nga pozicionet e punës “Inspektor Finance, Inspektor Pagash dhe Inspektor Kontabiliteti”, institucioni i mbikëqyrur ka organizuar procedurat e pranimin në shërbim civil. Për këtë qëllim është krijuar Komisioni i Pranimin në Kategorinë Ekzekutive, me urdhrin nr. 08, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë. Që në fazën e parë të konkurrimin, atë të lëvizjes paralele, ka paraqitur kandidaturën nëpunësja ***** (e cila është nëpunës civil në aparatit e bashkisë), e në përfundim të vlerësimit, është shpallur fituese me më shumë se 70 pikë, nga Komisioni për t’u punësuar në një nga pozicionet e mësipërme.

Në të tre procedurat e konkurrimin më sipër, u konstatuan këto parregullsi:

- Nuk është hartuar plani vjetor i pranimin në shërbimin civil për vitin 2016, në bazë të të cilit do të nisnin procedurat e konkurrimin, por konkurrimet janë zhvilluar kur është paraqitur nevoja.
- Nuk janë publikuar aktet e shpalljes për vendet vakante në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.
- Nuk janë publikuar as aktet e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak e përfundimtar si dhe akti i shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues, me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

Ligjvënësi në pikën 1, të nenit 20, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përcakton se pranimi në shërbimin civil bazohet në parimin e shanseve të barabarta, meritës,

aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Komisioneri vlerëson se mos bërja publike e aktit të shpalljes së vendit vakant vjen në kundërshtim me parimin e transparencës dhe shanseve të barabarta.

Konkluzione:

Për rregullimin e ligjshmërisë, e cila rezulton se nuk është zbatuar nga institucioni, njësia përgjegjëse, për të realizuar një procedurë konkurrimi në përputhje me ligjin për shërbimin civil, duhet të veprojë sipas kërkesave të mëposhtme:

- ✓ Pas përfundimit të procesit të ristrukturimit të përcaktuar në rubrikën 3, të këtij raporti, njësia përgjegjëse të drejtojë procesin për të hartuar planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2017, në përmbajtje të të cilit të pasqyrohen vendet që do të mbeten vakante nga ristrukturimi.
- ✓ Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2017 dhe në të ardhmen, duhet të bëhet publik në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të institucionit dhe në stendat për njoftime publike të institucionit, sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
- ✓ Njësia përgjegjëse, në bazë të këtij plani duhet të zhvillojë procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira.
- ✓ Njësia përgjegjëse në të ardhmen, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV, “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:
 1. Të krijohen Komisionet përkatëse të vlerësimit (*Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryej vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
 2. Të bëjë publik në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Fushë-Arrëz, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, dokumentet e nevojshme për kryerjen e procesit të rekrutimit:
 - a) Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*);

dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

- b) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- c) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”
- d) Aktin e shpalljes së kandidatit fitues, me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

Gjithashtu, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz, se gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

4) ***Vlerësimi i rezultateve në punë dhe procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur nëpunësve kompetentë të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues).***

Nga verifikimi në institucionin e mbikëqyrur u konstatua se vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit civil, nuk janë realizuar nga nëpunësit kompetentë, për asnjë periudhë nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar e deri aktualisht.

Konkluzion:

Njësia përgjegjëse duhet të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e akteve të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2016 dhe vlerësimin e ndërmjetëm të rezultateve në punë për vitin 2016, për të gjithë nëpunësit civilë të Bashkisë Fushë-Arrëz, sipas kërkesave të nenit 62, të ligjit nr. 125/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Formularit të Vlerësimit nr. 2, bashkangjitur dhe miratuar me vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”. Procesi duhet të fillojë me plotësimin e detyrës së lënë në këtë raport, për përpilimin e përshkrimeve të punës për gjithë pozicionet që përfshihen në shërbimin civil.

Kjo detyrë duhet të plotësohet menjëherë, brenda afateve që do të caktojë Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vendimin e miratimit të raportit përfundimtar.

5) ***Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.***

Në këtë mbikëqyrje, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, “*Për përmbajtjen,*

procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, të Këshillit të Ministrave.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se jo në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore; etj.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar për secilin nëpunës në anekset që i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

Aneksi nr. 1 *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), të nëpunësve civil të rekrutuar me konkurrim sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin, të administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe të Njësisë Administrative në varësinë e saj.*

Aneksi nr. 2 *Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.*

Nga këto të dhëna, konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrur, **30%** e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil, pranë këtij institucioni janë femra (**12 punonjës**), dhe **70 %** e tyre janë meshkuj (**28 punonjës**), ndërkohë që, moshë mesatare e nëpunësve civil është rreth **39** vjeç.

Përsa i përket, dokumentacionit në dosjet e personelit, konstatohet se, në këtë institucion, mungonin, **1** dokument që vërteton identitetin (*ID ose Pasaportë*), **21** dokumente që vërtetojnë gjendjen gjyqësore dhe **8** dokumente që vërtetojnë aftësinë shëndetësore për të punuar, (*raport mjekësor*).

Në lidhje me arsimin, konstatohet se, në **11** raste, punonjësit nuk kanë mbaruar arsimin e lartë, në **22** raste, punonjësit kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike, në **7** raste, punonjësit e kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore private.

Për mirë administrimin e shërbimit civil, Komisioneri sugjeron që, njësisë së burimeve njerëzore t’i lihet detyrë që:

1. Të plotësohet fleta prezantuese dhe t’i bashkëngjitet dosjes teknike të nëpunësit sipas lidhjes nr. 2 “*Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit*” bashkëngjitur vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe*

administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, të Këshillit të Ministrave.

2. Të plotësohen të gjitha aktet e emërimit që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e nëpunësit nga momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim (*aktet që pasqyrojnë ndryshim të pozicionit të punës, strukturim të pozicionit të punës, ndryshim të kategorisë së pozicionit të punës etj. ndryshime që lidhen me pozicionin e punës*) të administrohen në një ndarje të veçantë të dosjes individuale të nëpunësit.
3. Përshkrimet e punës, dhe vlerësimet e punës të plotësuar në mënyrën e duhur dhe të nënshkruara nga nëpunësit/strukturat kompetente (*të hartuara, të nënshkruara dhe të formalizuara si çdo dokument tjetër zyrtar*) të administrohen në dosjen individuale të nëpunësit civil. Kjo për faktin se, përshkrimi i punës dhe vlerësimi i punës në rubrikat apo në ndarjet e tyre trajtojnë elemente të ndryshme që kanë lidhje me gjithë dinamikën e karrierës së nëpunësit civil, ndër të cilat, kërkesat e posaçme të vendit të punës, nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për pozicionin e punës etj.

Konkluzion:

Konstatohet se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga njësi përgjegjëse e institucionit, ndërkohë që duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjen e personelit sipas kërkesave të mësipërme si dhe me dokumentet e evidentuara në aneksin përkatës bashkëngjitur raportit.

- **Probleme të konstatuara gjatë mbikëqyrjes**

Në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e ish Komunave që aktualisht janë njësi administrative e Bashkisë Fushë Arrëz, në këtë material janë trajtuar vetëm punonjësit të cilët aktualisht janë pjesë e kësaj bashkie.

Kjo situatë, ka ardhur për arsye se, Bashkia Fushë Arrëz, nuk dispononte të gjithë dokumentacionin, që duhej të ishte transferuar nga komunat e bashkuara me të, gjatë procesit të konstituimit. Grupi i punës i autorizuar nga Komisioneri për këtë mbikëqyrje, ka konstatuar faktin se, mungojnë dosjet individuale të punonjësve që ishin në marrëdhënie pune në këto komuna, në momentin kur ligji për shërbimin civil filloi efektet juridike, si dhe strukturat organizative të këtyre komunave. Ky fakt e ka bërë objektivist të pamundur, trajtimin e tyre (*nëse ka*) në këtë material.

Në këto kushte, për sa analizuam më sipër, njësi përgjegjëse e institucionit të grumbullojë strukturat analitike të komunave, si dhe dosjet e personelit për punonjësit që kanë qenë në pozicione pune pjesë të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për shërbimin civil.

* *
*

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Fushë-Arrëz, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, duke u nisur nga fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin Civil*”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat respektive, të cilat janë pjesë e këtij raporti.

Njësia përgjegjëse e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrë masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA